

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. 2124 Rep.  
Nr. 683 Kol.



### KONTRATE

(Për shitjen e aksioneve të shoqërisë "A.S.K. OIL sh.a.)

Sot në Tiranë me datë 31.05.2011 (dymijë e njëmbëdhjetë), përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë Majlinda Lleshi, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

Xhezmi KADI, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, me 16.08.1959, mbajtës i leternjoftimit Id Nr 030874149, titullar i 100 aksioneve që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, Shoqërisë "A.S.K. OIL" Sh.a., shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS-K82109004K, madhor e me zotësi të plote për të vepruar; madhor e me zotësi të plote për të vepruar në vijim referuar "Shitësi"

Dhe

Jorgo MANO, i biri i Koços dhe i Erifilit i datelindjes 25.11.1960, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit ID Nr 025176644, në vijim referuar "Blerësi"

### MEQENËSE

- a) Shitësi zotëron 100 aksione, të cilat përbejnë 100% të kapitalit, të Shoqërisë "A.S.K. OIL" Sh.a (Shoqëria), shoqëri aksionare e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS - K82109004K.
- b) Shoqëria ka një kapital të regjistruar në vlerën Lek 2.000.000 (dy milion) i ndarë në 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 20.000 (njëzet mijë) lek secili;
- c) Shitësi dhe Blerësi kanë dakord që Shitësi t'i shesin Blerësit 100 aksione që përbejnë 100% të kapitalit të Shoqërisë në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, bazuar edhe në vendimin datë 31.05.2011 të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë.
- d) Blerësi dëshiron t'i blejë nga Shitësit aksionet e specifikuar me sipër;
- e) Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

Meqenëse ekzistojnë kushtet me sipër, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. Objekti i Kontratës

Sipas kushteve te parashikuara ne ketë Kontrate, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit blen nga Shitësit 100( njeqind ) aksione qe përbejnë 100% te kapitalit te Shoqërisë Shoqërisë "A.S.K. OIL" Sh.a.

2. Çmimi i shitjes

- - Aksionet shiten (transferohen) kundrejt vlerës 2.000.000 leke ( dy milion leke), vlere e cila është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale

3. Transferimi i pronësisë mbi aksionet

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësit tek Blerësi ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate. Perfaqesuesi ligjor ( Administratori ) ngarkohet te beje ndryshimet perkatese ne librin e aksionereve te shoqerise.

4. Te ndryshme

Pas shitjes (transferimit) te pjesëve te kapitalit, Blerësi bëhet pronar i ligjshëm te 100 aksioneve qe përbejnë 100% te pjesëve te kapitalit te Shoqërisë dhe ushtrojnë të gjitha të drejtat që ligji i njej zotëruesit të aksioneve të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate si nga pikëpamja e ushtrimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimeve. Shitësi humbet te gjithë te drejtat qe buronin nga aksionet e shitura dhe deklaron se nuk ka pretendime te asnjë lloji ndaj shoqërisë dhe/ose aksionareve te saj.

Pas këtij transferimi aksionet e Shoqërisë "A.S.K. OIL" Sh.a., zotërohen si vijon:

- Z. Jorgo Mano zotëron 100 aksioneve qe përfaqësojnë 100% te kapitalit themeltar te Shoqërisë;

5. Baza Ligjore

Kjo kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne përputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë dhe te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe te Statutit te Shoqërisë si dhe çdo dispozite tjetër ligjore te cilës i behet referim ne ketë kontrate.

Kjo kontrate pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet ne përputhje me vullnetin e lire e te plote te palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre ne praninë time ne gjashte kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj ketë sipas ligjit.

SHITËSI

Xhezmi KADI



BLERËSI

Jorgo MANO

